



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 256, Datë 02.12.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR
VLERËSIMIN E GATISHMËRISË SË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË TË
DITËS NË AVANCË**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 30, pika 5 e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2473 prot., datë 02.12.2024 të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë”,

Konstatoi se:

- ERE, në bazë të nenit 30, pika 5, të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, është ngarkuar me përgjegjësinë për të vlerësuar gatishmërinë e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, duke u fokusuar veçanërisht te likuiditeti i tij pas krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
- Metodologjia synon të përcaktojë parimet dhe treguesit kryesorë që do të udhëzojnë vlerësimin e përgjithshëm të gatishmërisë së tregut, duke përfshirë aspekte që lidhen me funksionalitetin operacional, likuiditetin dhe integritetin e tij.
- Metodologjia e hartuar përbëhet nga tre pjesë kryesore: Pjesa e parë: Përfshin dispozitat e përgjithshme, duke përfshirë qëllimin, bazën ligjore dhe përkufizimet që shërbejnë si themel për vlerësimin e gatishmërisë së tregut. Pjesa e dytë: Përcakton parimet udhëzuese, treguesit kryesorë për vlerësim, procesin e hartimit të raportit dhe kriteret për përzgjedhjen e vendeve krahasuese nga Bashkimi Evropian. Kjo pjesë synon të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse dhe të standardizuar për funksionalitetin e tregut. Pjesa e tretë: Trajton dispozitat përfundimtare, duke përfshirë procedurat për rishikimin dhe ndryshimin e metodologjisë, si dhe përcaktimin e datës së hyrjes në fuqi.

- ERE do të mbështetet në të dhënat e siguruar nga Bursa Shqiptare e Energjisë, autoritetet rregullatore dhe bursat e vendeve të BE-së për të vlerësuar likuiditetin, transparencën dhe harmonizimin me standardet evropiane.
- ERE duhet të sigurojë përmbushjen e disa kritereve kryesore për vlerësimin e gatishmërisë, duke përfshirë: Krijimin e një burse operationale që ofron çmime reference për një periudhë të pandërprerë 10-mujore; Zbatimin e rregullave për integritetin dhe transparencën në treg; Krahasimin e vëllimeve të tregtuara me tregje të ngjashme në vende të Bashkimit Europian.
- Ndërkohë, treguesit kryesorë për vlerësim përfshijnë: Disponueshmëria e çmimeve: Sigurimi i një sinjali të qëndrueshëm dhe të pandërprerë për një periudhë 10-mujore dhe Faktorin e qarkullimit: Matja e sasisë së energjisë së tregtuar në raport me konsumin total, duke përdorur formulat standarde.
- Duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi për zhvillimin e tregut të energjisë, ky draft do të publikohet në faqen zyrtare të ERE-s, me qëllim mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve nga të gjithë aktorët e tregut shqiptar të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë”.
2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) sh.a. si dhe palët e tjera të interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI